

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC-09-0021**

Në padinë e

[REDAKTUE], kompani private,

Prishtinë,

Përfaqësuar nga [REDAKTUE]

dhe [REDAKTUE],

avokatë në Prishtinë

*Paditësi/Ankuesi*

*kundër*

**NSH "ZAKA",**

Prishtinë, e përfaqësuar nga

Agjencia Kosovare e Privatizimit

*E Paditura*

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc.Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit/Ankuesit kundër aktvendimit të Trupit Gjykues të DHPGJS-së të 18 marsit 2009, SCA-08-0068, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 tetor 2010, lëshon këtë

## **AKTVENDIM**

**1. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.**

**2. Me rastin e ankesës, eliminohet pika II e aktvendimit të Trupit Gjykues të 18 marsit 2009, SCA-08-0068.**

**3. Obligohet Ankuesi që të paguaj taksat gjyqësore në shumën prej 60,-- euro në Dhomën e Posaçme.**

**Arsyet Ligjore:**

DHPGJS-ja, më 20 nëntor 2007, SCC-07-0424, ia referoi Gjykatës Komunale të Prishtinës padinë pronësore të Paditësit, e ushtruar më 18 tetor 2007.

Me aktvendimin e saj të 16 prillit 2008, Cr. 88/08, Gjykata Komunale në Prishtinë e pezulloi procedurën duke iu referuar njoftimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) të 7 shtatorit 2007, duke thënë se likuidimi i të Paditurës kishte filluar më 25 korrik 2007.

Me aktvendimin e atakuar të 18 marsit 2009, SCA-08-0068, Trupi Gjykues i DHPGJS-së e refuzoi ankesën e Paditësit dhe e miratoi aktvendimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës të datës 16 prill 2008, Cr. 88/08 (pika I), duke paraqitur më tutje se mund të ushtrohet ankesë "brenda një muaji" (në Kolegjin e Ankesave) (pika II). Aktvendimi iu dërgua avokatit [REDACTED] më 29 prill 2009, dhe me 7 maj 2009 avokatit [REDACTED].

Në ankesën e tij, të dorëzuar më 11 qershor 2010 (nga avokati [REDACTED] [REDACTED] Paditësi/Ankuesi kërkoi revokimin e këtij aktvendimi.

Ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Në pajtim me nenin 9.5 të RREG të UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër një aktvendimi mund t'i ushtrohet me shkrim Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i aktvendimit (ASC-09-0096, ASC-10-0012 dhe të tjera).

Në kundërshtim me këtë dispozitë, neni 59.1 i UA-së UNMIK-ut 2008/6 përcakton se 'ankesa duhet të ushtrohet në Dhomën e Posaçme brenda dy muajve nga pranimi i aktgjykimit nga pala e cila ankohet'. Megjithatë, neni 9.5 i RREG të UNMIK-ut 2008/4 është mbizotëruar si normë më e lartë juridike.

Prandaj, fushëveprimi i aplikimit të nenit 59.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 kufizohet në lëndët të cilat nuk i përfshinë nenit 9.5 i RREG të UNMIK-ut.

Neni 20.1 i UA-së UNMIK-ut 2008/6 thotë se periudha e përcaktuar me RREG të UNMIK-ut 2008/4 do të llogaritet si vijon: Kur periudha e shprehur me ditë, llogaritet nga momenti kur ndodh ngjarja (këtu: pranimi i aktvendimit), kurse dita kur ndodhë ngjarja nuk do të llogaritet pasi që bie në periudhën në fjalë (krahaso nenin 112 [1] të Kodit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare 4/77-1478 dhe të tjerët të RSFJ-së, i cili e ndjek të njëjtin formulim).

Nëse pala përzgjedhë të përfaqësohet nga më shumë se një përfaqësues, dërgimi i parë te njëri nga ata është përcaktues për llogaritjen e periudhës për ushtrimin e ankesës.

Aktvendimi i atakuar i është dërguar avokatit [REDACTED] më 29 prill 2009, dhe avokatit [REDACTED] më 7 maj 2009. Kjo do të thotë se periudha prej 30 (tridhjetë) ditëve ka përfunduar më 29 maj 2009. Ankesa u ushtrua më 11 qershor 2010, shumë vonë (shih ASC-09-0096, ASC-10-0012 dhe të tjerat). Për më tepër edhe nëse llogaritet nga data e dërgimit të aktvendimit te avokati [REDACTED] ankesa do të ishte pas afatit.

Si pasojë, ankesa e pas afatshme duhet të refuzohet si e papranueshme, pa u marrë me meritat e saj.

Pika II e aktvendimit të atakuar duhet të eliminohet në këtë ankesë, pasi që udhëzimet për të ushtruar ankesë duke e cituar ligjin, pa diskrecion nga Gjykata, nuk janë vendime që duhet të merren në dispozitiv. Informatat e tillë duhet të jepen në arsyetim ligjor apo – më mirë – vetëm t'i bashkëngjiten aktvendimit, por nuk mund të jenë pjesë e tij (shih ASC-09-0075, ASC-09-0108, ASC-10-0023, ASC-10-0036, dhe të tjerët). Prandaj, siç u tha më lartë se afati kohor për ushtrimin e ankesës është 30 (tridhjetë) ditë, dhe jo një muaj, siç është shënuar në mënyrë të gabuar në aktvendimin e atakuar.

Në bazë të nenit 11 të RREG të UNMIK-ut 2008/4 dhe nenit 66 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Trupi Gjyques duhet të vendos për caktimin e shpenzimeve të procedurës në shkallën e parë, dhe Kolegji i Ankesave – kur të vendos

përfundimisht për një lëndë – për caktimin e shpenzimeve të procedurës në dy shkallët.

Në bazë të nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 Dhomë e Posaçme ka nxjerrë Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore.

Aty thuhet si vijon:

'Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, lidhur me "Tarifat e Taksave Gjyqësore" – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i aplikueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te neni 10.23 janë të aplikueshëm – mutatis mutandis – për procedurën ankimore para Trupit Gjykues dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, neni 10.11 është i aplikueshëm edhe për procedurën që drejton ankimin kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjykues.

(...)

Këto Rregulla Plotësuese Procedurale kanë hyrë në fuqi më 30 qershor 2010, të cilat i amandamentojnë Rregullat Plotësuese Procedurale në lidhje me Taksat Gjyqësore të 10 marsit 2010.

Ato gjithashtu përfshijnë dhe aplikohen në të gjitha operimet e DHPGJS-së nga janari 2010, sipas nevojës, dhe janë të vlefshme deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallët përbëhen, në njérën anë nga një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjeter nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Pasi që aktvendimi në shkallën e parë është lëshuar para ditës së hyrjes në fuqi të rregullave të përmendura më lartë, vetëm taksat gjyqësore të procedurës ankimore do të trajtohen këtu:

Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës siç rregullohet me nenin 10.11 të Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Tksave Gjyqësore ("ADJ") është 30,-- Euro.

Neni 10.15 ADJ përcakton se për aktvendimet për hedhjen e padive (si të papranueshme) duhet të paguhet vetëm gjysma e taksës të rregulluar në nenin 10.1 ADJ (që parimisht i bazon tksat gjyqësore në vlerën e padisë), deri në shumën maksimale prej 30,-- Euro. Kjo vlen edhe për aktvendimet në shkallën e dytë (neni 10.21 ADJ i referohet neneve 10.12 deri 10.18 ADJ). Neni 10.15 në lidhje me nenin 10.21 përfshin aktvendimet në shkallën e dytë që hedhin poshtë ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë që nuk i prekin meritat e lëndës.

Përveç kur vlera e padisë dëshmohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga paditësi, në shkallën e dytë nga ankuesi), sipas nenit 10.1 në lidhje me nenet 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30,-- Euro.

Në lëndën në fjalë, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë nuk janë bërë deklarimet për vlerën e padisë. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendimin në shkallën e dytë është përcaktuar 30,-- Euro.

Si rrjedhojë, tksat gjyqësore në vijim do të aplikohen përfundimisht për procedurën ankimore:

Tarifat e tksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e tksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
Gjithsej	60 Euro

Këto taksa gjyqësore do të barten nga Ankuesi.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it \_\_\_\_\_

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it \_\_\_\_\_

Mr.sc.Sahit Sylejmani, Gjyqtar \_\_\_\_\_

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it \_\_\_\_\_